REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:071236

Datë: 27.01.2020

Numri i dokumentit: 00786774

P.nr.26/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues **Drilon Haraçia,** me procesmbajtësen Valbone Hoxha, në çështjen penale kundër të akuzuarës L.(R.).C. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë truporë nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar1.4 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1650/2018, të datës 27.12.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik, **me datën 22.01.2019**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarës dhe të dëmtuarës B.I., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli dhe e përpiloj këtë,

A K T GJ Y K I M

E akuzuara:

L.C., nga i ati R., e ëma S., e gjinisë K., data e lindjes..., në Gjakovë, me vendbanim në Gjakovë, e martuar, nënë e 9 (nëntë) fëmijëve, e pa punë-amvise, analfabete, e gjendjes së dobët ekonomike, ashkali-shtetase e Republikës se Kosovës, me numër personal...

Ë SH T Ë F A J T O R E

Sepse me datën 22.10.2018 rreth orës 12:00/h, në rr. "A.I." në Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshme të shëndetit në atë mënyrë që pas një mos marrëveshje lidhur me një biçikletë të cilën djali i të dëmtuarës B.I., Xh., ia kishte marr djalit të pandehurës L., V., ku e njëjta me të kuptuar shkon tek shtëpia e të dëmtuarës B., të cilën me shkop druri e godet në këmbën e majtë, nën gju, duke i shkaktuar kështu lëndime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr.V.K. e dt.13.12.2018.

Me këto veprime ka kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe nenit 188 par.2 lidhur me par.1 nën par 1.4 të KPRK-së, të akuzuarës ia shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

2019:073018

E dëmtuara: B.I. nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

E akuzuara L.C., lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, dhe të njëjtat bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1650/2018 të datës 27.12.2018, kundër të akuzuarës L.C. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë truporë nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar1.4 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarës L. , andaj ka propozuar që e njëjta të shpallët fajtore dhe të dënohet sipas ligji.

E akuzuara L.C., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale, dhe është penduar për veprën penale duke kërkuar falje për veprën e kryer si dhe duke i propozuar Gjatës që ti shqiptoj një dënim më të butë.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, duke dhënën mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarës ka deklaruar se: nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana të akuzuarës, pasi që e njëjta pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë, pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat dhe faktet të cilat janë bashkangjitur akuzës.

E dëmtuara B.I., ka deklaruar se pajtohem lidhur me pranimin e fajësisë, duke shtuar se me palën e akuzuar jemi pajtuar dhe nuk kemi asnjë problem.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara se me datën 22.10.2018 rreth orës 12:00/h, në rr. “A.I.” në Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshme të shëndetit në atë mënyrë që pas një mos marrëveshje lidhur me një biçikletë të cilën djali i të dëmtuarës B.I., Xh., ia kishte marr djalit të pandehurës L., V., ku e njëjta me të kuptuar shkon tek shtëpia e të dëmtuarës B., të cilën me shkop druri e godet në këmbën e majtë, nën gju, duke i shkaktuar kështu lëndime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr.V.K. e dt.13.12.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara, e cila në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës përkatësisht pushimin e procedurës penale.

2019:073018

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën të shpall fajtore dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarës: se është nënë e 5 (pesë) fëmijëve, e pa punë-amvise, e gjendjes shume të varfër ekonomike, mbajtëse e familjes prej 7 anëtarësh, të ardhurat i siguron vetëm me anë të lëmoshës, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e saj dhe premtimin e saj se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale do të jetë me e kujdesshme, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëj rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarën është marr konform nenit 453 par.4 të KPP-së, për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e shpenzimeve do të rrezikohej gjendja materiale e të akuzuarës pasi që është e gjendjes shumë të varfër ekonomike, si dhe duke marr për bazë faktin është pa punë, mbajtëse e vetme e familjes si dhe faktin se të ardhurat i siguron kryesisht vetëm përmes lëmoshës dhe duka marrë për batë se është përfituese e ndihmës sociale.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.26/19, me datë 22.01.2020

Procesmbajtësja,
Valbone Hoxha

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

2019:073018